



raporti i **MONITORIMIT** PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 5

(periudha e raportimit:

dhjetor 2017- mars 2018)

Скопје, април 2018

Projekti:

Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



Ky publikim është hartuar në kuadër të Projektit: "Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë", i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë britanike.

Përmbajtja:

Hyrja.....	4
Informativiteti i ueb lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM dhe llogaridhënia e ofruar ndaj publikut më të gjerë.....	5
Informativiteti i ueb lokacionit të Këshillit Gjyqësor.....	5
Llogaridhënia e ofruar ndaj publikut më të gjerë.....	6
Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM.....	6
EFEKTSHMËRIA E PUNËS SË KGJRM.....	7
Zhvillimi i procedurës për zgjedhjen e gjykatësve.....	7
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e gjykatësve.....	7
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e gjykatësve në gjykatat më të larta.....	7
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave.....	8
Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore për gjykatës dhe kryetarë të gjykatave.....	8
Zgjedhja e gjykatësve-porot.....	8
Referimi i përkohshëm i gjykatësve.....	8
EFEKTSHMËRIA E PUNËS SË KGJRM – VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM.....	8
Ndryshimet e reja të Ligjit të KGJRM:.....	9
KËSHILLI I PËRCAKTIMIT TË FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIT TË PËRGJEGJËSISË SË GJYKATËSIT.....	10

HYRJA

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është një organ i pavarur, i cili siguron dhe garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kompetencat, mënyra dhe procedurat e punës së Këshillit Gjyqësor të RM rregullohen me Kushtetutën e RM, Ligjin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë¹ dhe me Rregullat e Punës së Këshillit Gjyqësor të RM.² Disa nga kompetencat që janë posaçërisht të rëndësishme për realizimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, e të cilat janë lëndë monitorimi janë: zgjedhja dhe shkarkimi i gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, vlerësimi dhe ndjekja e punës së gjykatësve, shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve tremujore dhe vjetore mbi punën e gjykatave, e ngjashëm.

Që nga viti 2015, përveç Këshillit Gjyqësor, filloi së ekzistuari edhe Këshilli i Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjes së Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit (në tekstin e mëtejshëm referuar si: Këshilli i Fakteve)³ përpara të cilit qytetarët ishin në mundësi të paraqisnin parashtesa për parregullsi në punën e gjykatësve, kryetarëve të gjykatave ose për zvarritjen e tepëruar të procedurave gjyqësore. Ky organ pushoi së ekzistuari me sjelljen e Ligjit të Pezullimit të Ligjit për Ndërprerjen e Vazhdimin të Ligjit të Këshillit të Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjes së Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit.⁴

Instituti për të Drejtat e Njeriut po e zbaton projektin "Mbikëqyrja e shtuar publike e punës së Këshillit Gjyqësor të RM" në periudhën nga shtatori 2016 deri në mars 2018, i cili është mbështetur nga Ambasada e Britanisë Shkup.⁵

Është ky **Raporti i pestë i Monitorimit** në kuadër të projektit, i cili përfshin periudhën **dhjetor 2017 - mars 2018**. Raporti i Monitorimit mbi Transparencën, Llogaridhënien dhe Efektshmërinë e Këshillit Gjyqësor të RM dhe e Këshillit të Fakteve është përpiluar në bazë të Matricës së Monitorimit, sipas treguesve të përcaktuar.⁶

1 Ligji i Këshillit Gjyqësor i RM, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 60/06, 150/10 dhe 100/11.

2 Rregullat e Punës së Këshillit Gjyqësor, Gazeta Zyrtare nr. 142, 22.11.2009.

3 Ligji i Këshillit të Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjes së Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjykatësit, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 20 e datës 12.2.2015.

4 Gazeta Zyrtare e RM, nr. 11 e datës 18.1.2018, i sjellë konform Planit të Qeverisë 3-6-9 për Reforma në Jurisprudencë.

5 Më tepër informacione mbi aktivitetet e projektit janë vënë në dispozicion në ueb faqen e Institutit për të Drejtat e Njeriut - www.ihr.org.mk, si dhe përmes aplikacionit celular, "Këshilli Gjyqësor nën Thjerëz", i vënë në dispozicion në Google Play dhe Apple Store.

6 Metodologjia e Ndjekjes së Punës së Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit të Përcaktimit të Fakteve, e vënë në dispozicion në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=182>.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

e gjelbër = plotësisht e përbushur

e kuqe = e pa përbushur

e verdhë = pjesërisht e përbushur

Informativiteti i ueb lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM dhe llogaridhënia e ofruar ndaj publikut më të gjerë

Ueb faqja www.sud.mk, e cila paraqet një platformë të integruar mbi gjyqësorin, është panoramike, mirëpo nuk është e lehtë për navigacion dhe nuk përmban të gjitha informacionet, gjegjësisht, një pjesë e të dhënave relevante nga ueb faqja e mëhershme e posaçme www.ssrn.mk ende nuk janë transferruar në këtë platformë.

Informativiteti i ueb lokacionit të Këshillit Gjyqësor⁷

AKTET QË SHPALLEN	STATUSI dhe vërejtjet e përgjithshme
Vendimet	Vendimet për zgjedhjen e gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave po shpallen në ueb faqen, por ato po qasen me vështirësi, sepse shpalljet e fundit gjenden në faqen e fundit, ndërsa më të vjetrat janë të listuara të para. Këshilli Gjyqësor shpalli edhe Vendimin mbi Normën (vendim ky për përcaktimin e numrit orientues të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjykatësi në bazë mujore, për vitin 2018)
Proceverbalet	Proceverbalet nuk shpallen me kohë ⁷ , është shpallur një procesverbal nga një seance të mbajtur në janar 2018
Komunikatat për seancat e caktuara	Komunikatat për seancat e caktuara po shpallen rregullisht në www.sud.mk në kreun "Këshilli Gjyqësor"
Komunikatat për seancat e mbajtura	Komunikatat për seancat e mbajtura po shpallen në ueb faqen menjëherë pas seancës së mbajtur. Megjithatë, ato nuk ngërthejnë në vete të dhëna më të hollësishme mbi seancën, përveç titullit të vendimit të sjellë.
Informacionet për publikun	Kreu Informacionet për Publikun nuk po azhurnohet. Të gjitha informacionet dhe komunikatat po shpallen në kreun e lajmeve.
Prokurimet publike	Lista e Prokurimeve Publike për vitin 2017 është azhurnuar edhe në formë të tabelës dhe është vënë në dispozicion vetëm në kreun e lajmeve të fundit. Megjithëse, jo edhe në pjesën të caktuar posaçërisht për "prokurimet publike". Kreu i Këshillit të Buxhetit Gjyqësor po azhurnohet.
Raportet tremujore mbi punën e gjykatave në RM	Këshilli Gjyqësor rregullisht, në çdo tre muaj, shqyrton dhe vlerëson raportet. Ata janë vënë në dispozicion në ueb faqen, në një pjesë të rezervuar për ata.

7 Me aktet ligjore dhe nënligjore nuk është përcaktuar obligimi për shpalljen e procesverbaleve të seancave.

Llogaridhënia e ofruar ndaj publikut më të gjerë^{8 9}

Informimi proaktiv i publikut	Vërejtjet e përgjithshme
Komunikatat	Më së shpeshi, Komunikatat kanë të bëjnë me mbajtjen e seancës dhe me vendimet dhe konkluzionet nga seancat e mbajtura. Me rastin e një debati televiziv, një pjesë e anëtarëve të KGJRM kërkuan të diskutohej mbi mënyrën se si gazetarët komentojnë punën e KGJRM, duke i fyer ata me fjalë përçmuese. Këshilli Gjyqësor shpalli një Komunikatë për Publikun me të cilën informon publikun se “në një emision televiziv të datës 12.2.2018, udhëheqësi-gazetar, si dhe pjesa më e madhe e të ftuarve në emisionin e tij, nuk kishin respektuar standardet profesionale dhe etike, kështu që, deklaratat e tyre kishin përmbajtur elemente të fyerjes dhe shpifjes, si dhe gjuhë të urrejtjes ndaj anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.” ⁸
Deklaratat	Pas seancave, në qoftë se ka gazetarë, Kryetari i KGJRM jep deklarata dhe u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve.
Konferencat për Shtyp	Në këtë periudhë, kryetari i KGJRM thirri një konferencë të posaçme për gazetarë. Në konferencën për shtyp u prezantuan qëndrime dhe reflektime, përveç mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM, ashtu edhe për zhvillimet tjera aktuale në fushën e jurisprudencës. Një javë pas kësaj, Këshilli Gjyqësor doli me një Komunikatë, me të cilën Kryetari i KGJRM po e informon publikun se qëndrimet e prezantuara në Konferencën për Shtyp të mbajtur më datë 4.1.2018, e të cilat nuk kanë të bëjnë me punën e Këshillit Gjyqësor të RM, paraqesin qëndrimin personal të Kryetarit. ⁹

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM

Raportet vjetore	Sipas Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Këshilli Gjyqësor përpilon Raport Vjetor për punën e vet. Këshilli Gjyqësor ia dërgoi Raportin Kuvendit të RM për shqyrtim dhe aprovim. Këshilli Gjyqësor duhet t’ua dërgojë Raportin të gjithë gjykatave në RM. Raporti duhet qenë publik dhe ai është shpallur në ueb faqen.
Vërejtjet e përgjithshme	Këshilli Gjyqësor ia parashtrroi Raportin për vitin 2016 Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në korrik 2017. Kuvendi ende nuk ka shqyrtuar Raportin.

⁸ Ueb faqja e KGJRM, Соопштение од дискусија за одржана седница на 15.2.2018.

⁹ Ueb faqja e KGJRM, Соопштение за јавност.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM – VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

- Në seancat e kësaj periudhe është shqyrtuar pothuajse secila pikë e rendit të ditës, ku inkuadroheshin më tepër anëtarë duke dhënë reflektimet dhe qëndrimet e veta mbi propozimet e dhëna në pikat e rendit të ditës.
- Gjatë aprovimit të Orarit Vjetor të Punës së KGJRM, është përcaktuar se me një softuer të posaçëm do të bëhej shpërndarja e parashtresave të marra nga qytetarët dhe personat juridikë, si kompetencë kjo e re e KGJRM. Secili anëtar do të detyrohet me një parashtrësë konkrete, në seancë publike do të sillet vendimi për të, dhe kështu do të shtohet edhe përgjegjësia individuale e anëtarëve të KGJRM.
- Shqyrtimi i Raportit të Ministrisë së Drejtësisë për keqpërdorim të sistemit AKMIS ishte i mbyllur për publikun, gjegjësisht, publiku u përjashtua për këtë pikë të rendit të ditës, me arsyetimin se, edhe pse një pjesë e gjërave tanimë janë komunikuar në publik, prapëprap ruajtja e dinjitetit dhe integritetit të gjykatësve është prioritet i KGJRM, ndërsa konkluzionet do të shpallen publikisht (për këtë Vendim, 11 anëtarë votuan “për”, ndërsa 3 “kundër”).

EFEKTSHMËRIA E PUNËS SË KGJRM

ZHVILLIMI I PROCEDURËS PËR ZGJEDHJEN E GJYKATËSVE

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e gjykatësve

Zgjedhja:	Këshilli zgjedh gjykatësin e Gjykatës Themelore nga rang lista e kandidatëve, e paraqitur nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, që i janë përgjigjur shpalljes.
Vërejtjet e përgjithshme	Në këtë periudhë nuk ka patur zgjedhje të gjykatësve në gjykatat themelore.

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e gjykatësve në gjykatat më të larta

Zgjedhja:	Janë publikuar të gjitha shpalljet për zgjedhjen e gjykatësve të Gjykatës Supreme të RM (fusha penale) dhe të Gjykatës së Apelit Shkup (fusha penale).
Vërejtjet e përgjithshme	Kjo shpallje për zgjedhjen e gjykatësve është e përsëritur, pasi që në nëntor 2017, me zgjedhjen e gjykatësve nuk u zgjodh numri i nevojitur i gjykatësve, edhe pse kishte një numër të mjaftueshëm të kandidatëve që po përmbushnin kushtet. Përskaj shpalljeve të përsëritura për zgjedhjen e gjykatësve, me votimin e parashikuar dhe zgjedhjen e kandidatëve nuk u bë zgjedhja, por u solli Vendimi mbi Vlerësimin e Jashtëzakonshëm të Kandidatëve për Gjykatës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe të Gjykatës së Apelit Shkup për vitin 2017, si dhe Vendimi mbi Formimin e Komisionit për Zbatimin e Vlerësimit të Jashtëzakonshëm dhe të Komisionit për Rivlerësim në bazë të Ankesave të Parashtruara në lidhje me Vlerësimin e Jashtëzakonshëm të Kandidatëve për Gjykatës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe Gjykatës së Apelit Shkup, për vitin 2017.

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave

Zgjedhja:	Në këtë periudhë u publikua Shpallja për Zgjedhjen e Kryetarëve të Gjykatave në vijim: Gjykata e Apelit Shkup dhe Gjykata Themelore Dibër Është sjellë edhe Vendimi për Zgjedhjen e Ushtruesit të Detyrës Kryetar i Gjykatës së Apelit Shkup
Lista e kriterëve	1. Kryetari i Gjykatës përzgjedhet nga rendi i gjykatësve të Republikës së Maqedonisë, me kushte, në procedurë dhe në mënyrë sikurse bëhet zgjedhja e gjykatësit në gjykatën përkatëse. 2. Vlerësimi i Programit të Punës së kandidatit për Kryetar (Kandidati për Kryetar të Gjykatës, së bashku me fletë-aplikimin dhe dokumentet tjera, paraqet edhe Programin e Punës në kuadër të mandatit të tij).
Vërejtjet e përgjithshme	Edhe krahas shpalljeve të përsëritura për zgjedhjen e kryetarëve, gjatë votimit të parashikuar dhe zgjedhjes së kandidatëve nuk u bë zgjedhja, por u sollli Vendimi mbi Vlerësimin e Jashtëzakonshëm të Punës së Kandidatëve për Kryetar të Gjykatës së Apelit Shkup, të Gjykatës Themelore Dibër, për vitin 2017, si dhe Vendimi për Formimin e Komisionit për Zbatimin e Vlerësimit të Jashtëzakonshëm dhe Komisionit për Rivlerësim në bazë të Ankesave të Parashtruara për Vlerësim të Jashtëzakonshëm të Punës së Kandidatëve për Kryetar të Gjykatës së Apelit Shkup dhe të Gjykatës Themelore Dibër, për vitin 2017.

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore për gjykatës dhe kryetarë të gjykatave

	Numri i procedurave
Dhjetor 2017 –shkurt 2018	Sipas Komunikatës për seancën e mbajtur, ishte sjellë një Aktvendim, me të cilin ishte shkarkuar një gjykatës, për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjykatësit, megjithatë ky Aktvendim nuk është shpallur në kreun "Vendimet". Gjatë kësaj periudhe, KGJRM ka sjellë 2 vendime për hedhje poshtë të procedurës dhe 1 vendim për ndërprerje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë për kryerje joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjykatësit (të shpallura në ueb faqen e KGJRM).

Zgjedhja e gjykatësve-porot

Numri i gjykatësve-porot	Konform Vendimit të KGJRM për përcaktimin e numrit të gjykatësve-porot në të gjitha gjykatat, për vitin 2015 janë parashikuar 1173 gjykatës-porot.
Vërejtjet e përgjithshme	Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Gjyqësor disa herë me radhë konstatoi zgjedhje dhe pezullim të funksionit të gjykatës-porot në disa gjykata në vend. Si problem kryesor konstatohet mungesa e gjykatësve-porot dhe numri i pamjaftueshëm i kandidatëve që paraqiten në shpalljet për zgjedhjen e gjykatësve-porot.

Referimi i përkohshëm i gjykatësve

Numri i gjykatësve të referuar përkohësisht	Numri i gjykatësve të referuar përkohësisht, për jo më gjatë se 1 vit
	2
Sa nga referimet e përkohshme janë bërë në kundërshtim me vullnetin e gjykatësit?	/
Vërejtjet e përgjithshme	Vendim për referim të përkohshëm për kryerje të funksionit të gjykatësit për: • një gjykatës të Gjykatës Themelore Strumicë për në Gjykatën Themelore Berovë, për një periudhë nga më së shumti 6 muaj nga data e referimit, dhe • një gjykatësi të Gjykatës Themelore Radovish për në Gjykatën Themelore Shën Nikollë, për një periudhë nga më së shumti 1 vit nga data e referimit.

EFEKTSHMËRIA E PUNËS SË KGJRM – VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

- Точката за избор на судии и претседатели за судови, на седницата одржана на 14 март 2018 г. предизвика реакции од одредени членови на ССРМ, откако еден член предложи да не се избираат судии и претседатели на судови по распишаните огласи, туку да се направи вондрено оценување на кандидатите, бидејќи се поминати повеќе од една година од последното оценување, врз основа на кое се направени и ранг-листите. Беше истакнато дека Извештајот на Министерството за правда, за злоупотреба на АКМИСОТ, дава индикации за рачно местење на предмети, па оттаму некои судии кои се кандидати за претседател на Апелационен суд Скопје не се праведно оценети, бидејќи немале можност со полн капацитет да решаваат предмети. Дел од членовите тврдеа дека е задоцнет предлогот, а дел го подржаа ваквото барање. (При гласањето за овој предлог 8 члена гласаа „за“ додека 6 члена беа „против“).
- Расправа имаше и околу висината на ориентациониот број предмети кои треба да ги решаваат судиите во 2018 година, асе предлагаше и да се намали нормата со оглед дека има тенденција на опаѓање на бројот на предмети во судовите. Се дадоа конструктивни предлози по однос на конкретни судови и бројот на решени предмети.
- По однос на одлуката за бројот на кандидати за упис во Академијата за судии и јавни обвинители, во наредните години потребно е да се направи дополнителна анализа за утврдување на точниот број потребни основни судии.

Нови измени на Законот за ССРМ:

Ndryshime të rëndësishme që u sollën me Ligjin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 197 e datës 29.12.2017:

- Kur Këshilli sjell vendim për zgjedhjen e një kryetari të një gjykate, ose për zgjedhjen e një gjykatësi, në asnjërin rast publiku nuk guxon të përjashtohet.¹⁰
- Secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote është i obliguar që publikisht, gjatë seancës së Këshillit, ta argumentojë vendimin e vet, si për zgjedhjen e gjykatësit, ashtu edhe për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës.¹¹
- Përcaktohet e drejta e kandidatit që nuk është zgjedhur për gjykatës ose për Kryetar të Gjykatës të jetë në mundësi të parashtrorë ankesë përpara Gjykatës Supreme të RM brenda 8 ditëve nga pranimi i lajmërimit, gjë kjo me të cilën është përmbushur hendeku juridik i pamundësisë së parashtrimit të mjetit të këtillë juridik.
- Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose Kryetarit të Gjykatës ngritet me kërkesë të një anëtar i Këshillit, përpara Kryetarit të Gjykatës, Kryetarit të Gjykatës së menjëhershme më të lartë ose gjatë seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të RM¹²

¹⁰ Neni 2 i Ligjit të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 197 e datës 29.12.2017

¹¹ Neni 3 dhe Neni 5 paragrafi 1 i ndryshimeve të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 197 e datës 29.12.2017

¹² Neni 3, paragrafi 3 i Ligjit të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 197 e datës 29.12.2017

KËSHILLI I PËRCAKTIMIT TË FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIT TË PËRGJEGJËSISË SË GJYKATËSIT

Këshilli i Përcaktimit të Fakteve pushoi së ekzistuari me sjelljen e Ligjit të Pezullimit të Ligjit të Përcaktimit të Fakteve, në janar 2018.¹³

Pas ndryshimeve të Ligjit të Këshillit Gjyqësor, procedura e përcaktimit të përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës ngritet me anë të kërkesës së një anëtari të Këshillit Gjyqësor, përpara Kryetarit të Gjykatës, Kryetarit të Gjykatës së menjëhershme më të lartë, ose gjatë seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të RM. Procedura është urgjente dhe është me karakter të besueshëm, zhvillohet pa praninë e publikut dhe me respektimin e prestigjit dhe dinjitetit të gjykatësit **ose të Kryetarit të Gjykatës, ku mbahet llogaria për mbrojtjen e të dhënave personale të gjykatësit ose të Kryetarit të Gjykatës, që është konform rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale.**¹⁴

- Deri në fund të janarit 2018, kanë arritur 219 parashtresa në Këshillin Gjyqësor, për të cilat duhet të procedohet, sipas kompetencës së tij të re. Nga ato, 5 kërkesa janë për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjykatësve, të paraqitura nga Këshilli i Fakteve.
- Në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor, janë shpallur 3 vendime, nga të cilat njëra kërkesë është hedhur poshtë si jo e plotë, njëra si e palejuar, ndërsa për një të tjetër kërkesë është sjellë vendim me të cilin ndërpritet procedura për përcaktimin e përgjegjësisë për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjykatësit, megjithëse vendimet kanë të bëjnë me procedura të vitit 2016.

¹³ Gazeta Zyrtare e RM, nr. 11 e datës 18.1.2018, i sjellë konform Planit të Qeverisë 3-6-9 për Reforma në Jurisprudencë

¹⁴ Neni 54, Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 197 e datës 29.12.2017.

Институтот за човекови права изготви мобилна апликација за следење на работата на Судскиот совет. Апликацијата може да ја преземете БЕСПЛАТНО на Google Play Store и на Apple Store под името „Судски совет под лупа“. Тука ќе ги најдете сите тековни информации и квартални извештаи изработени во рамките на проектот „Зголемен јавен надзор врз работата на Судскиот совет на РМ“.

